

VËSHTRIM MBI SAKTËSINË E HADITHEVE TË TRAJTUARA NGA LITERATURAT ISLAME NË PERIUDHËN 1945-2022¹

Veprimtaria e Hadithit në gjuhën shqipe. Trajtimi i Hadithit si materie shkencore

Hadithi, si fjalë e Muhamedit (a.s.), ndonjëherë shkruhej nga shokët e tij, por më shumë mësohej përmendësh. Nuk ka dyshim, se praktikimi i tij në jetën e përditshme ishte garancia më e mirë e ruajtjes së tij. Kështu që në shërbim të ruajtjes së fjalës së tij u bënë bashkë aleatët më të sigurt; shkrimi, mësimi përmendësh dhe praktikimi në jetë.

I ruajtur me këto masa sigurie, ende pa kaluar tre shekuj, u formua një bibliotekë e madhe e cila përmbante thëniet e Muhamedit (a.s.) dhe komentin e tyre, si dhe bibliografinë e personave që i transmetonin ato thënie. Andaj, prej sistemeve më të rëndësishme që zbuluan myslimanët në transmetimin e atyre njohurive, është “Menhexhul Isnadi” (sistemi i mbështetjes së thënieve). Domethënë, kushdo që pretendon se ka mësuar diçka, patjetër duhet ta përmendë se prej kujt ka mësuar, e kështu, derisa të përfundojë ky zinxhir, deri te shoku i Muhamedit (a.s.) i cili dëgjoi dhe mësoi nga ai drejtpërdrejt.

Kjo ndikoi që të studiohet jeta e çdo personi që mori pjesë në transmetimin e Sunetit të Muhamedit (a.s.), kështu që prej tyre kërkohet të jenë: myslimanë, besnikë, të mençur, apo njerëz normalë, të jenë të shkathët në mësimin përmendësh dhe të zbatojnë Kuranin dhe Sunetin e Muhamedit (a.s.). Kështu pra, u shoshit çdo gjë që u transmetua prej Muhamedit (a.s.).²

1 Fjala “Hadith” vjen nga gjuha arabe. Në aspektin leksikor (gjuhësor) do të thotë “El xhedidu” diçka e re, por edhe si lajm me të cilin kuptohet të shprehurit (el-lafdhu). Ndërsa në aspektin terminologjik do të thotë; “Çdo gjë që buron nga i dërguari i Allahut Muhammedi a.s. qoftë kjo fjalë, vepër, pëlqim, cilësi njerëzore, morale, trupore, personale etj.”

2 Imam Nevevi, Rijadus-Salihin (Kopshtet e të devotshmëve)- version i shkurtuar, i përkthyer në gjuhën shqipe nga Miftar Ajdini, Qemajl Morina dhe Nexhat Ibrahim, botoi Logos-A, Shkup, 1416/1996- botimi i II, f. xiii.

Për t'i shërbyer sa më mirë fjalës dhe trashëgimisë së tij, myslimanët – dijetarët prej tyre – krijuan një shkencë të tërë me rregulla, kritere e standarde të cilat në mënyrën më besnike do të viheshin në shërbim të hadithit të Pejgamberit (a.s.). Angazhimi ishte i gjithanshëm: disa e mësonin përmendësh, të tjerët ishin në mision të udhëtimeve për t'ia interpretuar atë të tjerëve, disa shquheshin për aftësinë e komentimit të domethënieve të hadithit, njihnin metodat e të folurit të Muhamedit (a.s.) dhe elokuencën (rrjedhshmërinë) e tij. Sa shumë prej dijetarëve u vunë në shërbim të njohjes dhe verifikimit të njerëzve që transmetonin hadithe! Ata krijuan dosje për ta, duke folur edhe rreth detajeve më të imta të jetës së tyre, me qëllimin e vetëm; që të njihet me saktësi jeta, karakteri dhe dinjiteti i tyre moral.

Në mbrojtje të hadithit, dijetarët nxorën rregulla mbi bazën e të cilave vlerësohet një fjalë - hadith i transmetuar nga Muhamedi (a.s.). Një term i tillë është nishan i cili identifikon masën e besueshmërisë së hadithit në fjalë. Edhe ne sot njohim hadithet mbi bazën e kritereve që kanë vendosur dijetarët e periudhave të mëhershme. Substanca identifikuese është e njëjtë dhe unike për myslimanët në mbarë botën. Ato mund të jenë të transmetuara nga Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Bejhekiu e të tjerë. Ndërsa mbi bazën e plotësimit të kushteve mund të jetë (sahih) i kategorisë së vërtetë, i asaj të mirë, diçka si i bukur (Hasen), i dobët (daif), apo (muvdu) krejt i trilluar, që nuk e ka thënë Pejgamberi (a.s.), por i është veshur atij.

Edhe ne përdorim po të njëjtën terminologji dhe mbi bazën e saj bëjmë identifikimin e hadithit, kush e ka transmetuar, në cilën përmbledhje gjendet, sa e saktë dhe se cila është shkalla e besueshmërisë së tij.

Mbi bazën e asaj që u tha, ne do të bëjmë një hulumtim për të parë se sa janë zbatuar masat e vendosura nga muhadithët në punimet e publikuara për Islam në gjuhën shqipe. Ne do të zgjedhim disa shembuj për të dëshmuar punën tonë.

Ato kanë të bëjnë me:

1. Devijimet në përkthim.
2. Mënyrën e paraqitjes së vlerësimit të hadithit dhe citimit të njësive bibliografike në fusnotë (poshtëshënim).

Një shembull mbi deformimin e domethënies së hadithit me rastin e përkthimit

Para disa vitesh, kur me studentët ishim duke bërë një debat rreth disa çështjeve fetare, njëri prej tyre m'u drejtua duke më pyetur, se pse nuk lejohet ta lexojmë Kuranin, ashtu siç e ka lexuar Pejgamberi, se cili ishte ky lexim, apo me çka dhe si dallohej. Natyrisht, mbeta i befasuar me këtë të dhënë, ngase nuk e kisha dëgjuar një gjë të tillë asnjëherë më parë. Më lehtë do të thosha se është fjala për ndonjë keqinterpretim, sesa të mendoja se studenti ka lexuar ndonjë hadith i cili konfirmon një gjë të tillë. Jo se pretendoj një përfshirje të gjerë të njohurive rreth haditheve, ngase atë nuk mund ta bëjë edhe një ekspert i kësaj lëmie, por për faktin se thëniet e Muhamedit (a.s.) kanë një rrjedhë logjike me domethënie të kapshme, e cila mund të supozohet si e natyrshme. Thjesht, nuk më kishte ndodhur të dëgjoja diçka të tillë. Po të kishte ndonjë lexim të Pejgamberit, i cilësuar me hadith dhe i përshkruar si lexim i veçantë për të, sigurisht që do të ishte bërë i njohur, ngase leximi i Kuranit është një angazhim i përhershëm i besimtarëve, ndërsa ekspertët e fushës merren edhe me detaje shumë të imta. Andaj, si të mos ishte i njohur leximi i Pejgamberit, lexim i cili është i veçantë për të, të cilin Allahu ia ka lejuar vetëm atij dhe askush tjetër nuk bën ta lexojë atë?!

Për të dëshmuar atë që tha, studenti nxori librin *Rijadu-Salihin*, të përkthyer në gjuhën shqipe, dhe nisi të lexojë përkthimin e hadithit 1011, rreth “Zbukurimit të zërit gjatë leximit të Kuranit”³, ku gjejmë hadithin:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّهُ سَمِعَ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ : (مَا أَدِنَ اللَّهُ لِشَيْءٍ مَا أَدِنَ لِنَبِيِّ حَسَنَ الصَّوْتِ يَتَعَنَّيَ بِالْقُرْآنِ ، يَجْهَرُ بِهِ)⁴

Ebu Hurejra (r.a.) ka transmetuar se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: “Allahu nuk i lejon askujt atë që ia ka lejuar Pejgamberit, që me zë të bukur, të lartë e melodik ta lexojë Kuranin.”

Hadithin me këtë tekst e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi në dy sahihët e tyre dhe me këtë konfirmohet saktësia e tij në nivelin më të lartë. Në këtë aspekt, nuk mund t'i bëhet vërejtje, ngase koleksioni i Buhariut dhe ai i Muslimit japin besueshmërinë e duhur, pa lënë mundësi për hamendje, apo pa nxitur asnjë dyshim.

3 Burimi i njëjtë, f. 359, hadithi nr. 1011.

4 El Buhari, Muhamed bin Ismail, Sahih El Buhari, nr. 6989, Muslim bin Haxhaxh, Sahih Muslim, nr. 1319, teksti i hadithit është marrë nga imam Muslimi.

Ndoshta nuk do të më kishte shkuar mendja që, pikërisht këtë hadith, ta bëja objekt studimi për të konfirmuar një shembull, se çfarë kuptimi të devijuar na sjell mosnjohja e domethënies së saktë të termave apo fjalive, në këtë rast të një fjale të vetme, por ndjeshmëria e temës është shumë e madhe, prandaj e pashë të arsyeshme ta sjell për trajtim. Është e njohur qartazi, se një term i caktuar mund të ketë më shumë se një domethënie, varësisht prej funksionit apo pozitës në fjali, ndërsa gjuha arabe në këtë fushë është edhe më e gjerë. Shumë herë fjalia apo termi duhet nxjerrë nga konteksti i domethënies gjuhësore, për ta orientuar drejt kuptimit të saktë të dhënë në tekst.

Domethënien e drejtë e ka devijuar kuptimi bukfal (fjalë për fjalë) i foljes **أَدَّى**, e cila në aspektin gjuhësor jep domethënien e lejimit (ka lejuar) dhe varësisht prej funksionit në fjali, konfirmon lejimin apo ndalimin. Mirëpo, në rastin e hadithit në fjalë, folja **أَدَّى** ka kuptimin e dëgjimit **استمعه** dhe tregon për dëgjim me përkushtimin dhe vëmendjen e duhur⁵, : **يقال : أدَّيتُ للشَّيْءِ آدًىً أَدْنًا : إِذَا سَمِعْتَ لَهُ**

Themi: “Kam dëgjuar diçka dhe ia vura veshin”, kur e dëgjon qëllimshëm dhe me vëmendje.⁶ Andaj kuptimi i drejtë i domethënies së hadithit do të ishte: “Allahu nuk ka dëgjuar ndonjë gjë (më të bukur e të këndshme), ashtu siç ka dëgjuar një Pejgamber që lexonte Kuranin me zë të bukur, të lartë e melodik”.

Për më tepër, folja **أَدَّى** ka edhe kuptime tjera, si **رضي**, që do të thotë: ka pëlqyer, ose është i pëlqimit. Edhe në këtë rast, na jep të njëjtin përkthim të hadithit, ku konfirmohet kënaqësia e Allahut me leximin e një Pejgamberi. Kur njeriut i pëlqen diçka, ai shpreh pëlqimin, kënaqësinë e tij dhe e dëgjon me vëmendje.

Mufesiri i mirënjohur, Ibën Kethiri, në lidhje me këtë hadith thotë: “Hadithi do të thotë se Allahu nuk ka dëgjuar ndonjë gjë tjetër, ashtu siç ka dëgjuar leximin e një pejgamberi (i cili) lexonte zëshëm dhe me zë të bukur, ngase në leximin e pejgamberëve bëhen bashkë zëri i bukur - si rezultat i personalitetit të tij unik - dhe frika e plotë nga Allahu (xh.sh.). Ky është synimi më i lartë. Allahu (xh.sh.) dëgjon zërat e gjithë robërve të Tij, qofshin ata bamirës apo mëkatarë, por gjithsesi, dëgjimi i leximit (lutjes e dhikrit) të robërve të Tij besimtarë është më madhështor.”⁷

5 Ebu Ubejd, El Kasim bin Selam, Garijbul Hadith, vëll. 1, f. 282.

6 El Begavi, Shehus Suneh, vëll. 4, f. 484.

7 Ibën Kethir, Fadailu el Kuran, f. 114.

Për pasojë, hadithi nuk paraqet ndalesë për besimtarët, që ata ta lexojnë Kuranin bukur, zëshëm dhe qartë, ashtu siç e ka lexuar një pejgamber. Por konfirmon se Allahut nuk i ka pëlqyer dhe nuk e ka kënaqur leximi i Kuranit nga askush, ashtu siç e ka kënaqur leximi nga një pejgamber, ngase ata zotërojnë vlera të veçanta dhe cilësi më të larta, në të cilat nuk i shoqëron askush nga njerëzit.

Përkthimi i hadithit në gjuhën shqipe paraqet një devijim të domethënies së tij, e cila, për pasojë, ka efekte të kundërta dhe jep informata jo të sakta, sikur konfirmon se për pejgamberët ka një lexim tjetër dhe besimtarët nuk e kanë të lejuar nga Allahu të lexojnë si pejgamberët. Është e qartë, se kjo nuk është aspak e saktë dhe se misioni i hadithit është krejt diçka tjetër. Hadithi është dëshmi, se leximi i pejgamberëve është i nivelit të lartë e të veçantë, që nuk mund të krahasohet me askënd tjetër dhe se gradën e tyre nuk mund ta arrijë askush.

Rreth përkthimit të *Rijadu Salihin*

Përkthimi i librit *Rijadu Salihin* ka ndodhur në një periudhë shumë të hershme dhe shumë të rëndësishme, kur kishte një mungesë të madhe të literaturës islame në gjuhën shqipe. Ky përkthim ka shënuar një progres shumë të madh në njohjen e tematikave të hadithit dhe ishte një sihariq i vërtetë, si për hoxhallarët, po ashtu edhe për masën e gjerë të besimtarëve, ngaqë ofronte njohuri burimore rreth trashëgimisë së Muhamedit (a.s.). Kështu, në mënyrë të dukshme, kishte shuar etjen e komunikimit me fjalët e të Dërguarit të Allahut.

Përkthimi është bërë nga tri personalitete shumë të njohura e të shquara, sidomos në fushën e fjalës së shkruar. Mund të themi se me shkrimet e tyre në fushën e publicistikës islame kanë rezervuar vendin në krye të radhitjes. Ky është realiteti që nuk mund ta injorojë askush.

Shembulli që sollëm me hadithin e trajtuar, është një lëshim i natyrës njerëzore dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet ndonjë akuzë, sado të lehtë, në projektin e përbashkët që kanë realizuar.

Përkthimi i *Rijadu Salihin* në gjuhën shqipe paraqet një thesar të njohjes së haditheve të Pejgamberit (a.s.), si për nga cilësia, po ashtu edhe nga sasia, ngase përzgjedhja e bërë nga imam Neveviu ka tubuar hadithet më autentike të vjela nga koleksione të ndryshme. Nuk ka dyshim, se Neveviu ishte mjeshër i njohjes së saktësisë së haditheve dhe domethënieve të tyre.

Lexuesit e përkthimit në gjuhën shqipe i besojnë zotimit që bëri autori, imam Neveviu, i cili, duke sqaruar metodologjinë e punës së tij në lidhje me cilësinë e haditheve, kishte thënë: “Kategorikisht, kam vendosur të mos theksoj asnjë tjetër, përpos haditheve të vërteta e të qarta, duke u mbështetur në përmbledhjet e njohura të librave të hadithit. Kam vendosur, po ashtu, që kaptinat (kapitujt) t’i hap me ajetet e Kuranit të Madhëruar, si dhe në fund të kaptinës t’i komentoj dhe shpjegoj kuptimet e paqarta me vërejtje e shpjegime të nevojshme.”

Pastaj vazhdon të sqarojë terminologjinë e përdorur rreth termave që nënkuptojnë shkallën e hadithit. Ai thotë: “Sa herë që theksoj në fund të hadithit fjalën *mettefekun alejhi*, do të thotë se hadithi gjendet në transmetim dhe përmbledhje të Buhariut dhe Muslimit.”⁸

Standardet e hadithit në punimet e revistës “Edukata Islame”

Mënyra e citimit të haditheve në fusnotë.

Sipas praktikës së shkrimeve të asaj kohe, hadithet nuk citohen me referenca për të dëshmuar burimin se nga ku janë marrë. Këtë praktikë e vërejmë te numrat e parë të revistës, ku autori apo autorët mjaftohen me cekjen e tekstit të hadithit, qoftë me tekst origjinal në gjuhën arabe, apo i transliteruar në gjuhën shqipe, duke sqaruar se është hadith, pa dhënë ndonjë sqarim tjetër më të detajuar, ashtu siç veprohet në kohët e sotme, kur ceket emri i autorit, librit, vëllimit dhe faqes, pastaj edhe të dhënat e tjera që plotësojnë të dhënat bibliografike në fusnotë. Kjo mënyrë e paraqitjes nuk është edhe aq problematike, sidomos nëse marrim parasysh periudhën kohore kur janë publikuar shkrimet e tilla, sepse edhe në nivelet më të larta, në botën shkencore dhe akademike, në ato kohë është vepruar pak a shumë në të njëjtën mënyrë.

Shumë autorë janë mjaftuar të thonë se është hadith, pa ofruar qasje në ndonjë fusnotë më të zgjeruar. Thënë realisht, paraqitja e fusnotës së detajuar me të dhënat specifike është kërkesë e standardeve të vendosura në periudhat e mëvonshme të publikimeve shkencore. Në këtë aspekt, nuk mund t’u bëhet vërejtje shkrimeve në fushën e hadithit të publikuara në revistën “Edukata Islame”.

8 Neveviu, Rijadu Salihiiin, f. 8.

Ajo që mund t'u bëhet vërejtje, për një cilësi më të mirë të mundshme, ka të bëjë me mungesën e vlerësimit të shkallës së hadithit. Atë që e tha Pejgamberi (a.s.), si fjalë e vepra, është bartur me rrugë transmetimi dhe mbi këtë bazë hadithet ndahen sipas përmbushjes së kritereve të vlerësimit dhe rezultojnë të jenë të sakta (sahiha), të mira (hasen), apo të dobëta (daife). Ky vlerësim është shumë i rëndësishëm, sepse përcakton të drejtën e argumentimit me hadithin e caktuar, ose të kundërtën - refuzimin e tij.

Në të shumtën e temave të publikuara të periudhës së parë, nuk jepen të dhëna rreth shkallës së hadithit dhe kjo mund të paraqesë një mungesë të dukshme në vlerësimin e standardeve të hadithit. Shumë herë shënohet teksti i transliteruar me shkronja shqipe, pa tekstin origjinal në gjuhën arabe. Këtë praktikë e gjejmë në përgjithësi te punimet e periudhës së viteve të para.

Megjithatë, gjejmë raste kur autori në fund të hadithit shënon emrin e autorit, librit nga ku është marrë hadithi, duke thënë p.sh.: Buhariu, Muslimi etj. Kemi gjetur raste kur si test i hadithit është vënë përkthimi, ndërsa në fusnotë është sjellë transliterimi i tij.

Shumë herë, hadithet janë shkruar me dorë dhe ashtu janë paraqitur në punim, duke zëvendësuar titullin. Këtë e gjejmë te shkrimet e mulla Sherifit i cili, duke marrë parasysht kohën kur punoi dhe mungesën e mjeteve të kohës së sotme për shkrimin, kopjimin dhe bartjen e hadithit, ai tekstin detyrohej ta shkruante me lapsin dhe dorën e tij të bereqetshme. Shumë mirë që e shkroi me dorën e tij! Në këtë mënyrë, neve na ka lënë shkrime e dorëshkrime të cilat paraqesin perlat e punës të gdhendura me dorë e të stolitura me shkronjat e gjuhës arabe, format e të cilave i njohin nxënësit e tij. Me kalimin e kohës, në numrat e mëvonshëm, ka ardhur deri te paraqitja më e dukshme e referencave në materialet e publikuara, megjithëse nuk ka pasur ndonjë standard unik për mënyrën e citimit të njëjësive bibliografike në fusnotë. Kjo, gjithsesi, ka të bëjë edhe me burimet e hadithit. Lexuesit dukshëm mund t'i bjerë në sy fakti se numrat e fundit përmbushin më shumë standardet e referencës dhe, në këtë aspekt, edhe referencat e hadithit shihet se qëndrojnë shumë më mirë. Megjithëse të dhënat nuk i gjejmë në fusnotë, ato janë vendosura gjatë shtjellimit, pas tekstit të përkthyer të hadithit.

Mostra mbi masën e zbatimit të standardeve të hadithit në përkthimet në gjuhën shqipe

Duke marrë parasysh vëllimin e literaturës mbi Islamin të publikuar në gjuhën shqipe, është shumë vështirë të bëhet një studim i tërësishëm, për të dalë në fund me një rezultat mbi masën e zbatimit të standardeve që parashihet shkenca e hadithit, si në vlerësimin e shkallës së haditheve, po ashtu edhe në komentet e tekstit dhe zërthimin e domethënies. Literatura e publikuar është e ndryshme. Prej tyre ka shumë përkthime nga autorët e huaj, nga gjuha arabe, angleze apo edhe boshnjake. Kemi një vëllim shumë të mirë të punimeve autoriale, të shkruara nga autorët vendorë që kanë kontribuar në publikimet e lëmive të ndryshme islame. Gati se në të gjitha gjejmë hadithe apo mendime të ndryshme rreth haditheve dhe tematikave që kanë të bëjnë me materien e hadithit. Terminologjia e hadithit është e pranishme gjithmonë, sepse përcakton ligjshmërinë e argumentimit me hadithe të caktuara. Në këtë hulumtim kemi zgjedhur disa punime të autorëve të ndryshëm, si modele për të vlerësuar se si kanë vepruar ata në rastin e trajtimit të haditheve, duke matur shkallën e saktësisë, apo edhe referimit në fusnotë.

Libri: Doktrinat e Tefsirit në trojet shqiptare⁹

Është e natyrshme dhe konstatim real, të themi se shqiptarët myslimanë i përkasin akides së Ehli Sunetit dhe se atë e kanë udhërrëfyes të jetës së tyre, ndaj edhe parimet në besim dhe doktrinën i ndërtojnë mbi bazën e saj.

Në këtë frymë autori ka paraqitur metodologjinë e punës së tij, duke thënë:

“... Pastaj do t'i përkthej tekstet e duhura në gjuhën arabe, në mënyrë precize dhe të saktë, duke respektuar çdo fjalë e mendim. Pastaj do t'i analizoj mendimet, rrymat dhe metodat në bazë të parimeve të Kuranit Fisnik, të Sunetit profetik autentik dhe të Ehli Sunetit¹⁰ dhe Xhematit...”

9 Tezë e Doktoraturës, punuar nga Pro. Dr. Hfz. Hajredin Hoxha, libri bazë është në gjuhën arabe, ndërsa është përkthyer në gjuhën shqipe nga Muhamed Mustafa, botuar në Tetovë, 2010.

10 Ehli Suneti janë njerëzit më të kujdesshëm në ndjekjen e Pejgamberit (a.s.), në njohjen e gjendjes së tij.

Ky sqarim është shumë i rëndësishëm, pasi autori ka bërë të qartë mbështetjen e tij në Kuran dhe Sunet, sipas praktikës së Ehli Sunetit. Por neve na intereson deklarimi i tij, se do të argumentojë me “Sunetin profetik autentik”, që nënkupton zotimin se gjatë punës së tij do të marrë për bazë vetëm hadithet e vërteta. Kështu që në frymën e zotimit të tij do të përcjellim atë që ka bërë në praktikë.

Gjatë komentit të sures *El Fatiha* ka sjellë atë që ka thënë Hafiz Ali Korça rreth ajetit: *إياك نعبد وإياك نستعين*, ku thotë: “Dashuria ndaj atdheut në Islam ka vlerë të madhe dhe, në këtë kontekst, në hadithin e Pejgamberit tonë (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thuhet se *Dashuria e vatanit është pjesë e imanit (besimit)*, për këtë shkak, kini kujdes nga tradhtia!...”

Në fusnotë¹¹ ka bërë vlerësimin e hadithit të cekur sipas standardeve të njohura të kritikës shkencore të haditheve, ku ajo që është transmetuar, i nënshtrohet rregullave për vlerësimin dhe gjykimin e haditheve mbi bazën e kritereve të përcaktuara. Duke sqaruar në fusnotë, ai thotë: “Imam San’ani thotë se ky hadith është *mevdu’ë* (i fabrikuar, i rrejshëm, i shpikur); ndërsa imam El Kari’iu në “el – Mekasid” thotë: *lem ekif alejhi* - nuk kam hasur në këtë hadith, megjithëse kuptimi (domethënia) e tij është e vërtetë... Vlefshmërinë e kuptimit të tij Imam San’ani e mbështet në ajetin kuranor ku besimtarët thonë: “S’kemi rrugë tjetër, përpos të luftojmë në rrugë të Zotit, ngase jemi nxjerrë nga shtëpitë tona.” (El Bekare, 246)

Nga kuptimi i hadithit mund të thuhet se me fjalën “vatan” mund të nënkuptohet Xheneti, ose nënkuptohet Mekka, meqë ishte qendra apo kible e botës...¹²

Duhet të themi se ky tekst hadithi paraqet një interesim shumë të madh për debate e polemika të cilat lidhen me imanin e vatanin dhe lidhjen mes tyre. Shumë herë hadithi në fjalë paraqet një infrastrukturë ligjore për argumentimin dhe mbështetjen e vlerave të përbashkëta. Autori ka sjellë dëshmi, se hadithi nuk është i qëndrueshëm, për më tepër, nuk është i vërtetë dhe nuk dëshmohet se është thënë nga Muhamedi (a.s.). Nuk gjendet asnjë zinxhir transmetuesish i cili vërteton se ky hadith është fjalë e Pejgamberit (a.s.). Fakti se ka kuptim pozitiv, nuk mund ta gradojë në hadith dhe, në anën tjetër, nuk rrëzon dashurinë për vendin e vatanin. Mbi bazën e argumenteve, dalim në përfundimin se nuk është hadith,

11 Po aty, f. 108.

12 El Axhluni, Keshful hafai ve muzilu el ilbas mima ishtehere minel ehadithi ala elsineti en nasi, viti 1999, vëll.1, f. 414.

nuk është thënë e nuk është folur nga Muhamedi (a.s.). Autori ka ndjekur metodat shkencore për vlerësimin dhe gjykimin e hadithit.

Një situatë të ngjashme kemi edhe në rastin kur autori cek¹³ hadithin të cilin e transmeton Tirmidhiu, ku Muhamedi (a.s.) thotë: “Do të ndodhin fitne (sprova)”. Dhe, kur e kanë pyetur: “Cila është rrugëdalja, o Pejgamber i Zotit?”, ai u ka thënë: “Libri i Zotit, në të keni informata për të kaluarën, për ata pas jush dhe vendim për ju”.

Me rastin e verifikimit të hadithit në fjalë, autori ka gjetur se teksti në gjuhën arabe nuk është identik me përkthimin, prandaj thotë se këtë hadith me këtë shprehje nuk e ka gjetur te imam Tirmidhiu. Duke shtuar se në versionin e Tirmidhiut, në Sunenin e tij nr. 2195, thuhet: “Kapitulli rreth faktit se do të ndodhin fitne (sprova) si nata e errët”.¹⁴

Në vazhdim të komentit, autori ka cekur hadithin: “Sikur të mos dinte Zoti diçka, nuk do të dinte për grimcat, karkalecin dhe mushkonjën”, të cilin nuk e ka hulumtuar për të dhënë një vlerësim mbi vlefshmërinë e tij, nëse është i saktë, apo jo. Sigurisht, është vënë në veshitë, ngase tekstit të hadithit në gjuhën shqipe nuk mund t’i gjendet lehtë origjinali i gjuhës arabe, sidomos në rastet kur tekstet e hulumtuara janë të panjohura, pse të mos themi, edhe jo shumë të qarta, si në shprehje, po ashtu edhe në kuptim. Një gjendje të tillë e kemi te hadithi të cilit po i bëjmë vërejtje. Më duhet të pranoj se edhe unë bëra një mundim për të hulumtuar rreth origjinalitetit të tij, por nuk arrita ndonjë rezultat. Megjithatë, mendojmë se autori është dashur së paku të deklarohet rreth vlerësimit të hadithit e jo ta kalojë në heshtje.

Libri: Për diturinë¹⁵

Qëllimisht zgjedha të marr për model këtë libër, meqë hoxhallarët në ligjëratat e tyre mbështeten shumë në hadithe, ose thënë më ndryshe, brumi i vaizit (predikuesit) të tyre është fermentuar nga materia e haditheve. Mulla Jakup Asipi kishte një energji të pashoqe të gjuhës, ligjërimit dhe të

13 Dr. Hajredin Hoxha, *Doktrinat e Tefsirit në trojet shqiptare*, f. 208.

14 Et Tirmidhi, Ebi Isa, Sunen et Tirmidhi, Bejrut- Liban, Daru Ihja et Turath el Arabi, vëll. 4, f. 487.

15 Libri është përmbledhje e ligjëratave të hoxhës së mirënjohur në të gjitha trojet shqiptare, alimit dhe trimit të pashoq, mulla Jakup Asipi. Përpunoi dhe sistemoi Avni Avdiu, ndërsa për hadithet është përkujdesur Profesori i Hadithit në Medresenë e Gjilanit, Muhamed Dërmaku, i biri i Hafëz Idris Dërmakut.

komunikimit. Ai shpërthente teksa lexonte fjalët e Muhamedit (a.s.), sepse zëri i dilte nga zemra, kumbimi ia mbushte fytin dhe, nga aty, i jehonte shumë fuqishëm. Në këtë punim kam për objektiv vlerësimin e disa rasteve kur në ligjërimet e bëra nga ai janë përdorur hadithet. Përndryshe, për të do të flisja në një mënyrë krejt tjetër dhe atëherë nuk do të ndjeja se thashë diçka të madhe për lavdërimin e tij.

Duke folur rreth aktualitetit të myslimanëve, urrejtjes e përçarjes, ofendimeve e gjykimeve, ai ka veçuar naivë e të paditur, të cilët myslimanët e tjerë i gjykojnë si jobesimtarë, pa kursyer edhe dijetarë të dalluar të këtij umeti.

Në sqarim, në fusnotë kishte thënë: “A nuk frikohen ata zotërinj, duke pasur parasysh thënien e Muhamedit (a.s.):

Kush i thotë qafir (jobesimtar) vëllait mysliman, pa qenë ai i tillë tek Allahu, atëherë kufri (mosbesimi) i kthehet si bumerang atij që e ka etiketuar me pa të drejtë?!”

Pastaj, në lidhje me vlerësimin e hadithit thotë: “Hadithi është muttefekun alejhi (i pranuar)”. E përmend Buhariu në librin “Edeb”, kaptina “men keffere ehahu bi gajri te’vil fehuve kema kalë”, 10/531, nr. 6104, si dhe Muslimi në librin “Iman”, kaptina “bejanu hali men kale liehihi muslim, ja kafir, 1/325/60, që të dy me zinxhir nëpërmjet Ibën Umerit”....¹⁶

Praktikën e adresimit të haditheve te burimet origjinale e gjejmë në vazhdimësi në fusnotat e librit në version më të zgjeruar. Një rast të tillë e kemi kur argumenton me hadithin: “Të kërkuarit e diturisë është detyrim për çdo mysliman- është detyrim për të gjithë pjesëtarët e Islamit”¹⁷. Në verifikimin e hadithit, në fusnotë, ka bërë një koment shumë të gjatë, ku ka cekur shumë libra dhe autorë të ndryshëm, të cilët kanë studiuar tekstin e hadithit, duke u përpjekur të gjejnë të vërtetën mbi gjendjen e tij. Meqë është shumë i përfolur dhe i goditur në versione të ndryshme transmetimi, kritikët e hadithit janë zgjeruar dhe thëlluar në hulumtimin e të gjithë personave dhe rrugëve të transmetimit të tij. E gjithë përpjekja ka synimin që këtij hadithi t’i gjejnë një fije shprese për ta adresuar si fjalë e Muhamedit (a.s.) dhe për të marrë ndonjë epitet të vlefshmërisë, veçanërisht pasi nuk ka të bëjë me ndonjë dispozitë e cila konfirmon hallallin apo haramin. Sidoqoftë, vlerësimi që Islami i bën diturisë dhe dijetarëve është fakt i dëshmuar me Kuran dhe Sunet, andaj

16 Jakup Asipi, Për Diturinë, Kumanovë, Botoi: Vllaznia, 2009, f. 69.

17 El Munavi, Fejdul Kadiir, vëll. 4, f. 267-268.

cilado qoftë gjendja e hadithit në fjalë, nuk mund ta ndryshojë këtë fakt, në asnjë mënyrë.¹⁸

Ajo që tërheq vëmendjen në punën e librit, ka të bëjë me mungesën e haditheve me tekst në gjuhën origjinale arabe. Duke parë seriozitetin me të cilin është përgatitur ky libër, mendojmë se kemi të drejtë t'u bëjmë vërejtje për një lëshim të tillë, posaçërisht kur kemi parasysh faktin se mulla Jakupi, ashtu siç e kemi njohur, ajetet dhe hadithet i ka cituar zëshëm dhe me shumë vetëbesim.

Një vështrim në botimet e planprogrameve mësimore islame

Botimet në fushën e Islamit në gjuhën shqipe kanë sjellë cilësi jo vetëm në vëllim, por, gjithsesi, edhe në vlerën shkencore dhe në përmbushjen e standardeve, si në përmbajtje, po ashtu edhe në njësitë bibliografike në fusnotë. Në këtë aspekt, kuadrot e rinj janë më të përparuar, ngaqë puna e tyre kërkon përfilljen e rregullave të caktuara me rastin e botimeve të ndryshme. Kjo është shumë më e dukshme në botimet e teksteve mësimore, si në Fakultetet Islame, po ashtu edhe në Medresetë në trojet shqiptare. Në botën e sotme shkencore një libër pa referenca është një punë jo shumë serioze dhe e pabazuar, ndërsa referenca e haditheve, apo citimi i burimit origjinal është një temë që nuk mund të anashkalohet. Nëse lexojmë një hadith, të gjithë vëmendjen e kanë te fundi i tij apo te fusnota; kush e transmeton dhe cili është vlerësimi për të. Nëse nuk jepet adresa e saktë, atëherë të tjerët kanë arsye të dyshojnë në saktësinë e subjektit.

Për interes të këtij hulumtimi kam shfletuar literaturën e cila është planprogram në institucionet mësimore islame. Me shumë përgjegjësi mund të konstatoj se kjo literaturë, në aspektin e hadithit dhe kritereve të tij, është shumë e mirë në nivelin e standardeve të kërkuara. Mësimet e ofruara japin siguri, nëse kanë për qëllim mbështetjen në hadithe dhe kjo është e dukshme në të gjitha lëndët mësimore. Në këtë aspekt, të dhënat ofrojnë shumë besueshmëri, sepse mbështetja në literaturën e gjuhës arabe ka mundësuar siguri dhe saktësi në adresimin e të dhënave. Gjithsesi, edhe mundësitë që ofron teknologjia bashkëkohore e hulumtimit, luajnë një rol të rëndësishëm, pasi me një kërkim mund

18 Po aty, f. 123.

të kesh para vetes shumë informata. Ajo që para disa vitesh është arritur me mund shumë të madh, sot mund të arrihet me shumë lehtësi dhe pa mundim. Vlerësimi i hadithit, gjegjësisht referimi i tij në fusnotë, mund të bëhet në formë më të zgjeruar, duke cekur të dhënat e plota¹⁹, që do të ishte puna më e mirë, por edhe mund të bëhet në versionin më të shkurtër, duke cekur vetëm burimin (librin) nga ku është marrë dhe numrin e hadithit²⁰. Që të dyja i gjejmë në literaturën e këtij lloji dhe, gjithsesi, kanë vlerën e vet, se identifikojnë shkallën e hadithit dhe burimin e tij.²¹

Duke pasur një njohje të përgjithshme me botimet e fushës së hadithit në gjuhën shqipe, mund të konstatoj se, deri më tani, është publikuar pak dhe, kur themi pak, kemi parasysh pak nga të gjitha degët e trungut Hadith. Ende nuk kemi të përkthyer apo të shkruara nga lloji i veprave kryesore që duhet të shohin dritën sa më shpejt. Kjo do të mund të arrihet me kontributin e individëve, por sigurisht që më lehtë do të realizohet nëse bëhet ndonjë organizim institucional.

Para pak kohësh, nëpërmjet rrjeteve sociale, kam dëgjuar për përkthimin e Sahihut të Muslimit, nga gjuha boshnjake në gjuhën shqipe, por ende nuk e kam parë. Po ashtu, është folur për disa projekte pune ekipore rreth Sahihut të Buhariut, ndoshta edhe disa vepra të tjera të cilat, me ndihmën e Allahut, shpresojmë ta shohin dritën sa më shpejt.

Nga ajo që është publikuar deri tani në fushën e hadithit, besoj se libri *Muhtesar Sahih El Buhari*²² është puna më unike që, e parë në shumë pikëpamje, plotëson të gjitha kriteret. Për nga ana e besueshmërisë, vetvetiu është libër me përmbajtje hadithesh të sigurta pa kurrfarë dyshimi. Umeti islam i beson saktësisë së haditheve të përmbledhura në Sahihun e Buhariut dhe, në këtë aspekt, janë të shkallës më të lartë të përmbushjes së kriterëve të saktësisë. Pasi kam punuar në leximin e tërësishëm të haditheve të kësaj përmbledhjeje, kam gjetur se përkthyesi ka bërë një punë të shkëlqyer, duke dhënë një shembull diturie, mundi,

19 Për një model të tillë, shih librin: Dr. Zija Abdullahu, Studim Krahasimtar i Feve, botoi Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë, 2010.

20 Shih: Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, Fikhu Hanefi, përktheu nga gjuha boshnjake Selim Sylejmani, botoi Drita e jetës, Gjiilan, 2006.

21 Për një model të tillë, shih librin: Prof. ass. Dr. Musa Vila, Nën Hijen e Haditheve të Resulullahut, botoi Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë.

22 Përmbledhje e librit Sahih el Buhari, Muhtesar Sahih el Buhari, zgjodhi dhe përmbledhi, Imam Zejnuddin Ahmed bin Abdul-Latif ez Zebidi. Përktheu nga arabishtja, Telat Sula, botoi Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, botimi i tretë, Mileniumi i ri, Tiranë, 2015.

durimi e përkushtimi. Angazhimi në këtë projekt i dijetarit të një kalibri të veçantë, si Mahmud Arnauti, përkthimit i shton vlerat shkencore e njerëzore.

Kësaj vepre të përkthyer ia shton vlerën edhe më shumë përkushtimi i botuesit, i cili këtë punë e bëri më së miri, duke u kujdesur deri në detaje, si nga ana teknike, po ashtu edhe estetike. Edhe ai që nuk e lexon, mëson shumëçka nga puna që është bërë për t'i shërbyer sa më mirë këtij libri. Po të udhëtonte dikush shumë larg për ta arritur, nuk do t'i shkonte huq mundi e po të shpenzonte shumë për ta blerë, nuk do të humbiste asgjë. Megjithatë, botuesi shumë herë e ka dhënë falas edhe ia ka ofruar kujt do.